Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika “b”, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika “a”, “c”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 28, datë

8.11.2019, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

1. Deklasifikim i plotë të kartelës model 2, në ngarkim të shtetasit Sh. H.
2. Deklasifikim i plotë i kartelës model 2, nr. 10245, në ngarkim të shtetasit K. R.
3. Deklasifikim i plotë i kartelës model 2, nr. 3030, sekret A. R. P, në ngarkim të shtetasit A. L.
4. Deklasifikim i plotë i kartelës model 2, nr. 13379, në ngarkim të shtetasit I. O.
5. Deklasifikim i plotë i kartelës model 2, nr. 6203, në ngarkim të shtetasit H. R.
6. Deklasifikim i plotë i shkresës nr. prot. 101, datë 04.09.2019, me lëndën “Informacion mbi dorëzimin e dokumenteve të fotokopjuara në përmbushje të përgjigjeve të praktikave të ndryshme nga sektori i përpunimit”, drejtuar Kryetares dhe Anëtarëve të Autoritetit, Drejtorisë së Informacionit, për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm.
7. Deklasifikim i plotë i shkresës nr. prot. 1154/3, datë 28.02.2019, me lëndën “Kthim përgjigje shkresës mbi identifikimin, mbledhjen, dorëzimin e dokumentacionit arkivor për shtetasin B. V.”, drejtuar Drejtorisë së Informacionit, për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm.
8. Deklasifikim i plotë i shkresës nr. prot. 144, datë 12.11.2018, me lëndën “Kthim përgjigje shkresës mbi identifikimin, mbledhjen, dorëzimin e dokumentacionit arkivor për shtetasin G. Gj.”, drejtuar Drejtorisë së Informacionit, për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm.
9. Deklasifikim i plotë i shkresës nr. prot. 52, datë 03.09.2019, me lëndën “Kthim përgjigje shkresës mbi identifikimin, mbledhjen, dorëzimin e dokumentacionit arkivor për R. H. Ç.”, drejtuar Drejtorisë së Informacionit, për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm.
10. Deklasifikim i plotë i shkresës nr. prot. 13, datë 15.02.2019, me lëndën “Kthim përgjigje shkresës mbi identifikimin, mbledhjen, dorëzimin e dokumentacionit arkivor për shtetasin K. R.”, drejtuar Drejtorisë së Informacionit, për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm.
11. Deklasifikim i plotë i shkresës nr. prot. 14, datë 28.02.2019, me lëndën “Kthim përgjigje shkresës mbi identifikimin, mbledhjen, dorëzimin e dokumentacionit arkivor të kërkuar nga Shoqata Antikomuniste e të Përndjekurve Politikë, dega Pogradec”, drejtuar Drejtorisë së Informacionit, për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm.
12. Deklasifikim i plotë i shkresës nr. prot. 122, datë 12.10.2018, me lëndën “Kthim përgjigje shkresës mbi identifikimin, mbledhjen, dorëzimin e dokumentacionit arkivor për shtetasin G. S.”, drejtuar Drejtorisë së Informacionit, për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm.
13. Deklasifikim i plotë i shkresës nr. prot. 36, datë 23.07.2018, me lëndën “Kthim përgjigje shkresës mbi identifikimin, mbledhjen, dorëzimin e dokumentacionit arkivor për I. O.”, drejtuar Drejtorisë së Informacionit, për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm.
14. Deklasifikim i plotë i shkresës nr. prot. 29, datë 12.04.2019, me lëndën “Kthim përgjigje shkresës mbi identifikimin, mbledhjen, dorëzimin e dokumentacionit arkivor për shtetasin N. A.”, drejtuar Drejtorisë së Informacionit, për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm.
15. Deklasifikim i plotë i shkresës nr. prot. 45, datë 24.05.2019, me lëndën “Informacion mbi dorëzimin e dokumenteve të fotokopjuara në përmbushje të përgjigjeve të praktikave të ndryshme nga sektori i përpunimit”, drejtuar Drejtorisë së Informacionit, për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm.
16. Deklasifikim i pjesshëm i regjistrit të agjunkturës Mat.
17. Deklasifikim i pjesshëm i regjistrit të agjunkturës, Dega e Punëve të Brendshme Gramsh.
18. Deklasifikim i pjesshëm i regjistrit të agjunkturës Krujë.

19. Deklasifikim i pjesshëm i regjistrit të agjencurës Berat.
20. Deklasifikim i pjesshëm i regjistrit të agjencurës Lushnjë.

KRYETARE E KDZH-së
Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 29, datë, 8.11. 2019.

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika “b”, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika “a”, “c”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 29, datë 8.11.2019, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

1. Regjistër model 1 i përpunimeve, nr. 14, datë 03.03.1987. Regjistri ka 154 (njëqind e pesëdhjetë e katër) fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
2. Regjistër model 17 internim-dëbimet, nr. 25, dt. 03.03.1987. Regjistri ka 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
3. Dosje personale dhe pune nr. 628, me 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) fletë, kategoria “agjent”, pseudonimi “Gramozi”, në ngarkim të shtetasit A. Q., niveli i klasifikimit të dosjes “tepër sekret”.
4. Dosje personale dhe pune nr. 7032, me 85 (tetëdhjetë e pesë) fletë, kategoria “agjent”, pseudonimi “Gurra”, në ngarkim të shtetasit T. Q., niveli i klasifikimit të dosjes “tepër sekret”.
5. Dosje personale dhe pune nr. 4557, me 427 (katërqind e njëzet e shtatë) fletë, kategoria “agjent”, pseudonimi “Numeratori”, në ngarkim të shtetasit M. B., niveli i klasifikimit të dosjes “tepër sekret”.

KRYETARE E KDZH-së
Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 30, datë 04.12.2019

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika “b” dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika “a”, “c”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin

nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 30, datë 04.12.2019, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

1. Dosje përpunimi nr. 793, kategoria 2/A, në ngarkim të V. I. G., me 91 (nëntëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
2. Dosje përpunimi nr. 238, kategoria 2/B, në ngarkim të J. A. N., me 128 (njëqind e njëzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
3. Dosje përpunimi nr. 584, kategoria 2/A, në ngarkim të L. H. Sh., me 170 (njëqind e shtatëdhjetë) fletë + 30 (tridhjetë) fletë në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
4. Dosje përpunimi nr. 682, kategoria 2/B, në ngarkim të K. A. K., me 270 (dyqind e shtatëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
5. Dosje përpunimi nr. 2264, kategoria 2/B, në ngarkim të Z. M. V., me 166 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
6. Dosja e të arratisurve me aktivitet nr. 241, zona Frashër, në ngarkim të Z. Q. M., Z. B. P., F. A. D., me 20 (njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
7. Dosja e të arratisurve me aktivitet nr. 243, zona Përmet, në ngarkim të V. T., P. A., S. T., Q. T., I. K., L. N., F. V., Th. G., Y. R. dhe F. K., me 100 (njëqind) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
8. Dosja e të arratisurve me aktivitet nr. 245, zona Këlcyrë, në ngarkim të H. Sh., S. H, M. S., H. K., I. K., K. S dhe J. C., me 32 (tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
9. Dosje drejtimi për agjitacion e propagandë armiqësore nr. 10 dhe fashikull për bashkëpunëtorët nr. 10, përkatësisht me 210 (dyqind e dhjetë) fletë dhe 39 (tridhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
10. Dosje drejtimi për të deklasuarit dhe elementët e tjerë antisocialistë me dy vëllime, nr. 117 me 49 (dyzet e nëntë) fletë dhe fashikull nr. 116 për ish-borgjezinë reaksionare. Niveli i klasifikimit të dosjeve është “sekret”.
11. Libër i kontigjenteve nr. 230, zona Frashër. Dokumenti ka 200 (dyqind) fletë.
12. Libër i kontigjenteve nr. 231, zona Çarshovë. Dokumenti ka 200 (dyqind) fletë.
13. Libër i kontigjenteve nr. 232, zona Përmet. Dokumenti ka 200 (dyqind) fletë.
14. Libër i kontigjenteve nr. 279, zona Këlcyrë. Dokumenti ka 200 (dyqind) fletë.
15. Libër i evidencës të punëtorit operativ nr. 224, zona Frashër, me 450 (katërqind e pesëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “sekret”.
16. Libër i evidencës të punëtorit operativ nr. 278, zona Këlcyrë, me 226 (dyqind e njëzet e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “sekret”.
17. Libër i evidencës të punëtorit operativ nr. 225, zona Çarshovë, me 226 (dyqind e njëzet e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “sekret”.

18. Regjistër këshillim-demaskime nr. 18, model 7, me 98 (nëntëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “sekret”.
19. Regjistër i kontigjenteve nr. 16, model 3, me 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “sekret”.
20. Dosje formulare nr. 616, kategoria 2/A, në ngarkim të D. E. B., me 48 (dyzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
21. Dosje agjenturore nr. 317, kategoria 2/A, në ngarkim të grupit agjental “Shushunja”, me 35 (tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
22. Dosje formulare nr. 3355, kategoria 2/B, në ngarkim të M. I. K., me 105 (njëqind e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
23. Dosje formulare nr. 3354, kategoria 2/B, në ngarkim të J. A. K., me 83 (tetëdhjetë e tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
24. Dosje e problemit të centralizuar nr. 5511-A, në ngarkim të grupit agjental “Murtaja”, me 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
25. Dosje personale nr. 3520-A, në ngarkim të Ll. J., me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 31, datë 05.12.2019

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika “b” dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika “a”, “c”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018 të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror” me vendimin nr. 31, datë 5.12.2019, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

1. Fondi nr. 4, Drejtoria e Parë e ish-Sigurimit të Shtetit, Historiku i anës së Sigurimit të Shtetit të Degës së Punëve të Brendshme Krujë, nga 1943-1978. Niveli i klasifikimit është “sekret”, 337 fletë. Deklasifikim i plotë.
2. Fondi nr. 4, Drejtoria e Parë e ish-Sigurimit të Shtetit, shtabi, viti 1990, dosje nr. 3, me titull “Plan pune nga detyrat që dalin nga fjala e Ramiz Alisë me kuadrot e MPB-së”, 15 fletë. Niveli i klasifikimit “sekret”. Deklasifikim i plotë.
3. Fondi nr. 4, Drejtoria e Parë e ish-Sigurimit të Shtetit, dega e parë, viti 1987, dosje nr. 80, me titull “Për L. A. dhe mikun e saj gjerman J. B.”, 5 fletë. Niveli i klasifikimit “sekret”. Deklasifikim i plotë.

4. Fondi nr. 4, Drejtoria e Parë e ish-Sigurimit të Shtetit, dega VIII, viti 1977, dosje nr. 161 me titull “Përgjithësime mbi zbulimin e goditjen e veprimtarisë armiqësore të një grupi kulakësh në rrethin e Beratit”, 13 fletë. Niveli i klasifikimit “sekret”.
5. Fondi nr. 4, Drejtoria e Parë e ish-Sigurimit të Shtetit, Dega II, viti 1957, dosje nr. 51 me titull “Informacion mbi veprimtarinë e elementit antiparti Xh. Q.”, 3 fletë. Niveli i klasifikimit “tepër sekret”. Deklasifikim i plotë.
6. Fondi 6, Drejtoria e Tretë e ish-Sigurimit të Shtetit, viti 1945, dosje nr. 29, me titull “Materiale mbi përpunimin agjental të K. Ç.”, 52 fletë. Niveli i klasifikimit “tepër sekret”. Deklasifikim i plotë.
7. Dosje personale dhe pune nr. 351, me 206 (dyqind e gjashtë) fletë, pseudonimi “Lahuta e Malësisë”, në ngarkim të shtetasit R. Th. Niveli i klasifikimit të dosjes “tepër sekret”. Deklasifikim i plotë.
8. Dosje përpunimi nr. 252, me 267 (dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) fletë, në ngarkim të I. L. Niveli i klasifikimit “tepër sekret”. Deklasifikim i plotë.
9. Fondi nr. 4, Drejtoria e Parë e ish-Sigurimit të Shtetit, dega e parë, viti 1955, dosje nr. 158 me titull “Historiku i emigrantëve politikë grekë të ardhur në Shqipëri dhe lista emërore e tyre”, 19 fletë. Niveli i klasifikimit “sekret”. Deklasifikim i plotë.
10. Fondi nr. 4, Drejtoria e Parë e ish-Sigurimit të Shtetit, dega e parë, viti 1946, dosje nr. 72 me titull “Mbi zhvillimin e procesit të “sabotatorëve të Maliqit”, 50 fletë. Deklasifikim i plotë.
11. Fondi nr. 4, Drejtoria e Parë e ish-Sigurimit të Shtetit, shtabi, viti 1987, dosje nr. 37 me titull “Korrespondencë me Hetuesinë e Përgjithshme për ndjekjen e disa personave si Xh. Q., A.N., F. L., P. Gj. dhe A.B.” 18 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”. Deklasifikim i plotë.
12. Fletë regjistri të agjunkturës nr. 2, grupi 2, me numër rendor 663, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Korçë, në ngarkim të M. L., 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit “sekret”. Deklasifikimin i pjesshëm.
13. Kartelë model 2, me nr. 6423, në ngarkim të shtetases E. L., me pseudonimin “Egnatia”.

KRYETARE E KDZH-së
Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 32, datë 06.12.2019

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika “b” dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika “a”, “c”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH” ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 32, datë

06.12.2019, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

1. Dosje përpunimi nr. 549, kategoria 2/A, në ngarkim të S. Sh. K., me 233 (dyqind e tridhjetë e tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
2. Dosje e problemit të centralizuar “Kubisti” nr. 812, kategoria 2/A, në ngarkim të F. M. P., me 276 (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
3. Dosje përpunimi nr. 11025, kategoria 2/A, në ngarkim të T. H. G., me 122 (njëqind e njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
4. Dosje formulare nr. 1615, kategoria 2/B, në ngarkim të K. I. S., me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
5. Dosje formulare nr. 756, kategoria 2/B, në ngarkim të B. Sh. M., me 90 (nëntëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
6. Dosje personale dhe pune nr. 378, në ngarkim të Dh. H. B., me 118 (njëqind e tetëmbëdhjetë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
7. Dosje formulare nr. 6226, kategoria 2/B, në ngarkim të V. J. N., me 23 (njëzet e tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
8. Fashikulli i çifutëve që banojnë në qytetin e Tiranës nr. 1219, me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
9. Dosje formulare nr. 1035, kategoria 2/A, në ngarkim të V. S. L., me 131 (njëqind e tridhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
10. Dosje formulare nr. 21534, kategoria 2/A, në ngarkim të P. T. D., me 190 (njëqind e nëntëdhjetë) fletë + 34 fletë (në zarf). Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
11. Dosje formulare nr. 12844, kategoria 2/A, në ngarkim të D. H. P., me 244 (dyqind e dyzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
12. Dosje formulare nr. 1318, kategoria 2/A, në ngarkim të V. I. Gj., me 508 (pesëqind e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
13. Dosar me 3 fashikuj: fashikull me implikime me 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) fletë, fashikull me aktakuzën me 70 (shtatëdhjetë) fletë dhe dosje e hetuesisë me deponime me 48 (dyzet e tetë) fletë, në ngarkim të B. A. B., me 194 (njëqind e nëntëdhjetë e katër) fletë në total. Niveli i klasifikimit është “tepër sekret”.
14. Dosje formulare nr. 45, kategoria P/P, me 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë dhe dosje hetimore nr. 45, me 95 (nëntëdhjetë e pesë) fletë, në ngarkim të Th. K. R. Niveli i klasifikimit të dosjeve është “tepër sekret”.
15. Dosje formulare nr. 1471, kategoria 2/A, në ngarkim të B. A. B., me 533 (pesëqind e tridhjetë e tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
16. Dosje formulare nr. 3210, kategoria 2/A, në ngarkim të Rr. P., me 332 (treqind e tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.

17. Fashikull me 2 vëllime nr. 1817 dhe 1817/1, kategoria 2/A, në ngarkim të T. K., përkatësisht me 98 (nëntëdhjetë e tetë) fletë dhe 196 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të fashikullit është “tepër sekret”.
18. Dosje formulare nr. 429, kategoria 2/A, në ngarkim të A. A. F., me 475 (katërqind e shtatëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
19. Dosje hetimore nr. 192, në ngarkim të A. A. F., me 237 (dyqind e tridhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 33, datë 12.12.2019

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika “b”, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika “a”, “c”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror” me vendimin nr. 33, datë 12.12.2019, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

1. Libër i evidencës së punëtorit operativ, nr. 226/1, zona Petran-Kosine, me 226 (dyqind e njëzet e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “sekret”.
2. Libër i evidencës së punëtorit operativ, nr. 228, zona Suke-Ballaban, me 226 (dyqind e njëzet e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “sekret”.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 35, datë 23.12.2019

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika “b” dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika “a”, “c”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin

nr. 13, datë 03.05.2018 të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror” me vendimin nr. 35, datë 23.12.2019, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

1. Libër i dorëzimit të të dhënave nr. 8, me 94 (nëntëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “sekret”.
2. Regjistri i dosjeve të Objektivit të Rëndësisë së Veçantë nr. 3, me 97 (nëntëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “sekret”.
3. Libër i dorëzimit të dokumenteve model 8, me 86 (tetëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “sekret”.
4. Dosje me procesverbale asgjësimi nr. 3/1, me 217 (dyqind e shtatëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “sekret”.
5. Procesverbal mbi asgjësimin e të dhënave në dosjen e informatave, me 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit është “sekret”.
6. Dosar me procesverbale nr. 1- nr. 151. Niveli i klasifikimit është “sekret”.
7. Dosar me procesverbale nr. 1- nr. 217. Niveli i klasifikimit është “sekret”.
8. Raport nr. 1176, datë 12.02.1989, Mbi rrëzimin e katër galerive, me 1(një) fletë. Niveli i klasifikimit është “sekret”.
9. Regjistri i dosjeve dhe i fashikujve nr. 19, me 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit është “sekret”.
10. Dosje ORV për Ndërmarrjen e Peshkimit nr. 35, tre fashikuj, me 376 (treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) fletë në total. Niveli i klasifikimit është “sekret”.
11. Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje përpunimi nr. 10, me 112 fletë, kategoria 2/A, në ngarkim të T. A. Niveli i klasifikimit “sekret”.
12. Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje objekti nr. 10, me 248 fletë, kategoria 2/A, në ngarkim të T. A. Niveli i klasifikimit “tepër sekret”.
13. Fondi “Grupet”, dosje me materiale dhe informacione për T. A., me 210 fletë. Niveli i klasifikimit “sekret”.
14. Dosje formulare nr. 14568, kategoria 2/A, në ngarkim të F. K., me 32 (tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
15. Dosje formulare nr. 1957 (205), në ngarkim të H. K., me 102 (njëqind e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
16. Fashikull me materiale përpunimi të I. G., me 50 (pesëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket fondit nr. 6, “Zbulimi politik”.
17. Fondi nr. 4, Drejtoria I, viti 1962, bandat, dosje nr. 171, “Relacion mbi diversantin P. K. dhe M. M.”, me 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
18. Fondi nr. 4, Drejtoria I, viti 1959, dega I, dosje nr. 242, “Relacione e deklarata nga persona kosovarë që bëjnë fjalë mbi E. M. dhe veprimtarinë e tij politike”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.

19. Dosje përpunimi nr. 5391 (2282), kategoria 2/B, në ngarkim të S. R., me 88 (tetëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
20. Dosje formulare nr. 2042 (6502), kategoria 2/B, në ngarkim të A. L., me 50 (pesëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
21. Fashikull nr. 981, në ngarkim të T. K., me 105 (njëqind e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të fashikullit është “tepër sekret”.
22. Dosje nr. 513, me 3 vëllime, në ngarkim të T. K., me 1108 fletë. Niveli i klasifikimit të dosjeve “tepër sekret”.
23. Dosje formulare nr. 1065, me 3 vëllime + 1 fashikull në ngarkim të A. K., me 705 (shtatëqind e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
24. Dosje agjenturore “Bretkoca” nr. 318, me 108 (njëqind e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
25. Fondi ish-arkivi i PPSH, Marrëdhëniet me ish-Ministrinë e Punëve të Brendshme, viti 1948, dosje nr. 1 “Raporte mbi veprimtarinë e shqiptarëve në vendet kapitaliste”, me 237 (dyqind e tridhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
26. Fondi ish-arkivi i PPSH, Marrëdhëniet me ish-Ministrinë e Punëve të Brendshme, viti 1989, dosje nr. 64, “Informacione. Komente lidhur me ngjarjet në Europën Lindore gjatë vitit 1989”, me 173 (njëqind e shtatëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
27. Dosje formulare nr. 4834, me dy vëllime, në ngarkim të I. K., me 248 (dyqind e dyzet e tetë) + 144 (njëqind e dyzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
28. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Berat (Ana e Sigurimit), dosje formulare nr. 953, kategoria 2/B, në ngarkim të Y. H, me 125 (njëqind e njëzet e pesë) fletë, plus 5 (pesë) fletë në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
29. Fondi operativ (Ana e Sigurimit), dosje formulare nr. 2902, kategoria 2/B, në ngarkim të T. A., me 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
30. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, dosje personale nr. 6162, me 24 (njëzet e katër) fletë, në ngarkim të B. M. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
31. Fondi “Të arratisur”, fashikull nr. 1448, me 188 (njëqind e tetëdhjetë e tetë) fletë, në ngarkim të S. M. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
32. Drejtoria II, fashikull me material për shkelësit e kufirit, me 41 (dyzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
33. Drejtoria II, Relacione për shkelësit e kufirit, me 25 (njëzet e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
34. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Durrës, dosje hetimore-gjyqësore nr. 167, në ngarkim të Xh. Q., përkatësisht me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë dhe 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjeve është “sekret”.
35. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Durrës, dosje përpunimi nr. 1820, kategoria 2/A, në ngarkim të Xh. Q., me 2 vëllime + 2 fashikuj për të dënuar, me 350 (treqind e pesëdhjetë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.

36. Fondi “Të arratisur”, dosje formulare nr. 239, me 8 (tetë) fletë, në ngarkim të M. K. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
37. Fondi “Të arratisur”, fashikull nr. 2367, me 46 (dyzet e gjashtë) fletë, në ngarkim të A. H. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
38. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje O.R.V. “Lidhja e Shkrimtarëve” nr. 125, me 3 vëllime, me 102 (njëqind e dy) fletë, në ngarkim të E. L. Niveli i klasifikimit të dosjeve është “sekret”.
39. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Elbasan, regjistër model 17, nr. 50, për personat e internuar dhe dëbuar, me 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “sekret”.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

VEPRIMTARI TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT PËR PERIUDHËN NËNTOR – DHJETOR

1. Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit midis AIDSSH dhe MHK

Në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Muzeut Historik Kombëtar, mes znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit dhe z. Dorian Koçi, Drejtor i Muzeut.

Objekt i marrëveshjes është institucionalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit të ndërsjellë, për mbështetjen e kërkimit shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së Sigurimit. Të dy institucionet do të bashkërendojnë punën për kryerjen e studimeve të bazuara në materialet arkivore mbi rolin dhe funksionimin e ish-Sigurimit të Shtetit në shtet e shoqëri, dhe do të hartojnë projekte mbi plane të përbashkëta vjetore të aktiviteteve për edukimin qytetar, konferenca, seminare, tryeza pune, etj. duke konsoliduar punën për njohjen e së shkuarës, në funksion të transparencës dhe komunikimit me publikun.



**Ekspozitë me profile të të zhdukurve në diktaturë
“E shkuara e pakryer”**

Tiranë, 11 dhjetor 2019 - Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Institutin e Integritetit të Ish-të Përndjekurve Politikë dhe ICMP (Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur) zhvilluan ceremoninë e hapjes së ekspozitës mbi të zhdukurit në diktaturë “E shkuara e pakryer”, në mjediset e Muzeu Historik Kombëtar.

Ekspozita u mbështet nga Fondacioni Konrad-Adenauer-Stiftung Albanien, mbi të dhëna dhe materiale arkivore të AIDSSH e vetë familjeve, raportime të të zhdukurve dhe vendvarrimeve pranë AIDSSH, IIPP e ICMP, dhe intervista me familjarët.

Në praninë e përfaqësuesve të Kuvendit, institucioneve publike qendrore dhe vendore, Prokurorit të Përgjithshëm z. Olsian Çela, organeve të drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme, trupit diplomatik, organizatave ndërkombëtare, shoqatave të të drejtave të njeriut dhe të përndjekurve politikë, përfaqësuesve të universiteteve, institucioneve homologe dhe kërkimore në vend, familjarëve dhe të mbijetuarve, AIDSSH trajtoi kauzën për gjetjen dhe rikthimin e dinjitetit njerëzor të rreth 6000 të zhdukurve në diktaturë, ende të pagjetur, në vendvarrime të panjohura për familjarët e tyre.

Lista me emrat e të zhdukurve të raportuar pranë institucioneve AIDSSH, ICMP e IIPP dhe harta e vendvarrimeve të raportuara/pretenduara që u prezantuan në ekspozitë, plotësoi profilet e të zhdukurve të njohur e të panjohur, nga të miturit, te mjekët, inxhinierët, gazetarët, mësuesit, bankierët deri te familje të tëra, intelektualë e klerikë, në të gjithë vendin.

“Kjo është një mundësi për t’i bërë bashkë familjet dhe institucionet, për të bashkërenduar punën mes aktorëve dhe avancuar çështjen e të zhdukurve, me hapa konkretë e të mirëmenduar”, u shpreh znj. Gentiana Sula. “Sfidat janë të mëdha, që te përmirësimi i kuadrit ligjor, që viktimave t’u garantohet e drejta e njohjes së të vërtetës për rrethanat e zhdukjes me forcë dhe e drejta për të kërkuar informacion, e drejta për drejtësi, deri te masat që duhet të ndërmerren shteti për ta mundësuar drejtësinë,” tha kryetarja e Autoritetit.

Z. Ulsi Manja, kryetar i Komisionit të Ligjeve shprehu angazhimin e Kuvendit të Shqipërisë për të ndërmarrë nisma konkrete në përmirësimet ligjore për identifikimin e vendvarrimeve dhe gjetjen e të zhdukurve.

I pranishëm në ceremoni, kryebashkiaku i Tiranës, z. Erion Veliaj, mori përsipër kthimin në vende kujtese të vendvarrimeve masive të të ekzekutuarve ende të pagjetur në zonën e Tiranës, duke nisur nga ai i Mënikut, deri te vendosja e një memoriali në kryeqytet, për të nderuar viktimat e diktaturës. “Fëmijët që humbën jetën në Tepelenë dhe që akoma sot rezultojnë të zhdukur, po ashtu përpjekjet e familjarëve të tyre për t’i gjetur dhe për t’u mundësuar një varrim të denjë e njerëzor, kërkesat e përsëritura për vullnet shtetëror e institucional për të mos i harruar janë arsye që çuan në këtë bashkëpunim me Autoritetin e Dosjeve, për të hedhur dritë në të kaluarën dhe për t’i afruar familjet me institucionet”, u shpreh z. Tobias Ruttershoff, drejtues i Fondacionit Konrad Adenauer për Shqipërinë, mbështetës i projektit.

Familjarë të viktimave të zhdukur, z. Nikolin Kurti dhe z. Hamza Kazazi, shembuj të rrallë të përpjekjeve për gjetjen e të afërmeve, -priftit të martirizuar, i Lumi Dom Shtjefën Kurti dhe shtatë të ekzekutuarve të zhdukur të familjes Kazazi - sollën përvojat e tyre të kërkimeve shumëvjeçare, sfidat me institucionet dhe përsëritën kërkesën për gjetjen dhe zhvarrimin e familjarëve në vendndodhjet e raportuara, duke ushtruar të drejtën njerëzore për t’i varrosur të afërmit e tyre. Në vijim, z. Bilal Kola renditi përpjekjet dhe vështirësitë e IIPP në identifikimin e vendvarrimeve dhe koordinimin me AIDSSH e ICMP për informacionin e njësuar për të zhdukurit.

Z. Luigj Ndou, përfaqësues i ICMP për Shqipërinë, e vuri theksin në nevojën për masa konkrete të institucioneve, duke filluar nga prokuroritë e qyteteve ku janë raportuar vendkzekutime apo vendvarrime, te bashkërendimi i veprimeve në arkiva, hapa ligjorë dhe ekspertizë. Përfaqësuesi i Kombeve të Bashkuara të Zhdukjeve me Forcë, z. Bernard Duhaime, i ardhur në Shqipëri posaçërisht për këtë aktivitet, përmendi përgjegjësitë e shoqërisë shqiptare për të shkuarën dhe të sotmen e saj, në zbatim në Konventës së OKB, të ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, për të koordinuar veprimet për evidentimin dhe kërkimin e personave të zhdukur, të pushkatuar me ose pa gjyq, ose të vdekur gjatë hetuesisë në regjimin komunist, për të mbrojtur të drejtat e anëtarëve të familjeve të personave të zhdukur, veçanërisht duke siguruar që vendndodhja e të zhdukurve dhe rrethanat e zhdukjes së tyre të hetohen në mënyrë efektive.

Në mbyllje të aktivitetit, aktori Mirush Kabashi solli rastin e dajës së vet të zhdukur, dhimbjen familjare shumëvjeçare, dhe interpretoi vargje të shkruara nga një i burgosur politik, me shpresën të liria e shumëpritur.

Për ekspozitën “E shkuara e pakryer” AIDSSH bashkëpunoi me gazetaren Fatmira Nikolli, për intervistat, tekstet dhe kontaktet me familjarët, në përpjekje për të ndërgjegjësuar për nevojën për përgjigje të familjeve mbi fatin dhe vendndodhjen e personave të humbur, si e drejtë për të ditur dhe e drejtë për të vërtetën.









2. Dialog lokal për diktaturën dhe ekspozitë dokumentare me materiale arkivore në zonën e Përmetit

Përmet, 13 dhjetor 2019 - Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Bashkinë Përmet dhe Shoqatën Antikomuniste të të Përndjekurve Politikë zhvilloi takimin e parë të Dialogut për Diktaturën në qytetin e Përmetit.

AIDSSH ekspozoi materiale arkivore të zonës, regjistra përpunimi, libra evidence, dosje përpunimi, hetimore-gjyqësore, dosje drejtimi të zonave të ndryshme të Përmetit, etj., duke i dhënë mundësi komunitetit të njihet me to, dhe të aplikojë për informim individual e për qëllime studimore.

Bazuar në këto dokumente, u prezantuan tipologji të dosjeve të përndjekjes, duke ndërvepruar me të pranishmit, që ndanë edhe përvoja e përjetime personale.

Në praninë e përfaqësuesve të institucioneve publike dhe universitetit të Gjirokastrës, familjarëve dhe të mbijetuarve, të rinjve, shoqatave të të drejtave të njeriut dhe të përndjekurve politikë, u theksua nevoja për një narrativë të re, të bazuar në kërkim shkencor, punë studimore dhe në terren, me mbledhje të dëshmime gojore, identifikim të vendeve të kujtesës dhe nderim të figurave e personaliteteve të zonës, nismë e mbështetur nga Bashkia Përmet.

AIDSSH dhe Bashkia Përmet synojnë ta vijnë bashkëpunimin për nxitjen e dialogut lokal mbi të shkuarën, në funksion të edukimit qytetar dhe konsolidimit të demokracisë.









Ambasadori gjerman në Shqipëri, z. Peter Zingraf, vizitë në AIDSSH

Tiranë, 17 dhjetor 2019 - Ambasadori gjerman në Shqipëri, z. Peter Zingraf, zhvilloi një vizitë pune në AIDSSH, ku u njoh me proceset e punës dhe projektet e institucionit.

Në praninë e Anëtarëve dhe përfaqësuesve të Sekretariatit Teknik, Kryetarja e Autoritetit, znj. Sula, bëri një paraqitje të punës së AIDSSH për zbardhjen e të shkuarës, bashkëpunimet me institucionet homologe, grupet e interesit dhe nismat për hapjen e studimit e dosjeve nëpërmjet aktiviteteve në nivel lokal e kombëtar.

Besueshmëria e institucioneve përballë sfidave të përditshme, trajtimi i dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit, puna me të rinjtë dhe komunitetet, ishin pjesë e bisedës së z. Zingraf me drejtues të Autoritetit, i cili u informua për veprimtaritë që kanë të bëjnë me kërkesat individuale, institucionale, studimore, mediatike, verifikimin e pastërtisë së figurave dhe punën me kërkimin shkencor e edukimin qytetar.

Ambasada Gjermane e ka mbështetur që nga fillimi aktivitetin e AIDSSH-së dhe rolin e tij për drejtësinë tranzicionale në vend.





Për një kujtesë të përbashkët europiane

Shenjim i vendvarrimeve dhe mbikëqyrje e posaçme në të gjitha njësitë vendore

Tiranë, 30 dhjetor 2019 – Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ka përshkallëzuar veprimet konkrete sa i takon bashkëpunimit mes institucioneve qendrore dhe lokale për të zhdukurit në diktaturë.

AIDSSH ka kërkuar nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, me shkresat përkatëse drejtuar secilës bashki në vend, që të merren masa për ruajtjen dhe mbrojtjen e vendeve të pushkatimit dhe vendvarrimeve të fshehta apo të deklaruara të periudhës së diktaturës, duke siguruar parandalimin e trajtimit të paligjshëm të vendeve të pushkatimit dhe vendvarrimeve; mostjetërsimin e sipërfaqeve të këtyre vendeve; frenimin e shkatërrimit të objekteve dhe vendeve ku janë evidentuar veprimtari të shtetit komunist ndaj individëve, duke i vendosur këto vende në ruajtje dhe mbrojtje të posaçme, mbështetur edhe në vëzhgimet e pasqyruara nga Grupi i Punës së Personave të Zhdukur me Forcë në Rezolutën e 2017 të Kombeve të Bashkuara, ku evidentohet si detyrë “shenjimi i vendeve ku mendohet të gjenden eshtra gjatë periudhës së diktaturës”, dhe kërkohet të ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm për gjetjen e personave të zhdukur.

Bashkëlidhur kërkesës, AIDSSH ka dorëzuar pranë bashkive hartën paraprake me vendvarrime të raportuara, (burimi IIPP dhe ICMP) dhe rezultatet e grumbulluara deri tani në nivel kombëtar nga aplikacionet e ICMP, Qendra e Kërkimit Online dhe Gjurmuesi i Vendvarrimeve, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të 2018 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur.

AIDSSH i ka kërkuar çdo bashkie dhe këshilli bashkiak të kryejë shenjimin e vendvarrimeve të mundshme të të pagjeturve në territorin e saj administrativ dhe njëherazi, të vendosë në mbrojtje (mbikëqyrje të posaçme) vendet e internimit, kampet e punës dhe burgjet, të raportuara më herët nga qytetarët.

Kërkesa e dërguar të gjitha bashkive të vendit, Kuvendit të Shqipërisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, është mbështetur në bashkëpunimin mes institucioneve publike, qendrore dhe lokale, shoqërisë civile dhe familjarëve, për ta kthyer vëmendjen te çështja e të zhdukurve dhe e drejta njerëzore për të vërtetën.

Deri tani, pranë AIDSSH janë paraqitur 75 kërkesa me objekt rehabilitimin dhe qartësimin e fatit të vdekurve apo të zhdukurve. Të gjitha raportimet i janë kaluar IIPP, që koordinon me AIDSSH e ICMP për informacionin e njësuar për rreth 6000 të zhdukur në diktaturë.

Më herët, AIDSSH ka ndërmarrë nisma konkrete dhe ka organizuar aktivitete në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve, Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Ditës së Përkujtimit të Viktimave të Regjimeve Totalitare, duke bashkëpunuar me institucionet dhe Prokurorinë për fillimin e procedurës së gjetjes dhe identifikimit të vendvarrimeve të personave të zhdukur në diktaturë.

Po ashtu, është bashkëpunuar me qeverisjen lokale duke paraqitur propozime për kthimin në vende kujtese:

-të Kampit të Tepelenës (1949-1951), bazuar në Urdhrin nr. 45, datë 6. 6. 2017 për “Ngritjen e grupit të punës për kërkimin e dokumentacionit arkivor për Kampin e Tepelenës dhe krijimin e një memoriali për përkujtimin e datës 30 gusht si Dita Ndërkombëtare e të Zhdukurve”.

-dhe të Mënikut (në Pezë), ku u zhvarrosën eshtrat e 22 intelektualëve të pushkatuar pa gjyq më 26 shkurt 1951, vendvarrim masiv i shumë të dënuarve nga diktatura, bazuar në propozimin e Autoritetit për këshillin bashkiak të Tiranës, për kthimin në vend të ndërgjegjes. Tashmë, rruga që të çon atje mban emrin “26 shkurti”.

AIDSSH ka bërë kërkesë pranë Ministrisë përgjegjëse për përfshirje në projektligjin “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” të një pike ku të përfshihen si vende kujtese dhe vetëdijësimi, vendet e pushkatimit dhe vendvarrimet e fshehta të periudhës së diktaturës komuniste.

Presidenti i Republikës, me propozim të AIDSSH, ka nderuar me titullin “Për merita të veçanta civile” dinjitetin njerëzor të 14 personave që u përballën pa bujë me sistemin komunist, duke trajtuar njerëzisht familjarët e tyre të zhdukur, më 23 gusht 2018 në kampin e Tepelenës, më 25 shkurt 2019, për zbulimin dhe zhvarrimin e 22 intelektualëve të ekzekutuar pa gjyq për “bombën” në legatën sovjetike dhe më 30 gusht 2019, viktimat e para të kampit të Tepelenës.

Filmi “Të zhdukurit” i gazetares Luljeta Progni, i mbështetur në dëshmi dhe dokumente arkivore mbi të zhdukurit në komunizëm, bashkëpunim i AIDSSH me Fondacionit Kujto.al, zbuloi histori të të zhdukurve dhe hodhi dritë mbi personalitete frymëzuese, të panjohur më herët për shoqërinë shqiptare.

Ekspozita “E shkuara e pakryer” e AIDSSH me gazetaren Fatmira Nikolli, me profile të të zhdukurve, hartën dhe listën e vendvarrimeve të raportuara, e vuri theksin tek e drejta për të ditur dhe e drejta për të vërtetën, që nuk mund të vijë pa angazhimin aktiv dhe marrjen e përgjegjësisë së institucioneve.

Projekti i përbashkët ICMP-AIDSSH “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit në komunizëm” 2020-2021, i mbështetur nga BE, synon të hartojë dhe publikojë një udhëzues mbi të drejtat dhe detyrimet e legjislacionit shqiptar e ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut, sa u takon personave të zhdukur në diktaturë për shkaqe politike dhe shkelje të të drejtave të njeriut. Udhëzuesi do të mbështetet me takime informuese, mbledhje të dëshmimeve dhe punë kërkimore në arkiva, për qartësimin e fatit të tyre.


AIDSSH do t’i propozojë Kuvendit të Shqipërisë përmirësime ligjore për të koordinuar më mirë punën mbi të zhdukurit, mes institucioneve, qeverisjes vendore, prokurorisë dhe familjeve. Përfaqësuesi i Kombeve të Bashkuara të Zhdukjeve me Forcë, z. Bernard Duhaime, i ftuar në ekspozitë “E shkuara e pakryer”, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, u shpreh se “për ta ruajtur sa më mirë kujtimin e viktimave, mbetet thelbësor zhvillimi i një strategjie për kujtesën, që merr parasysh rëndësinë e të ruajturit zyrtarisht të vendeve të mëparshme të paraburgimit dhe kampeve të punës si vende të kujtesës; si dhe shenjimi i vendeve, ngritja e përmendoreve e memorialeve për njohjen dhe rehabilitimin e viktimave.”

Në shtator 2019, Parlamenti Europian miratoi rezolutën mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët europiane, duke shprehur respekt për secilën viktimë të sistemeve totalitare dhe mbështetje për përkujtimin e tyre. Duke pasur parasysh që kujtimet e së kaluarës tragjike të Europës duhet të mbahen gjallë, në mënyrë që të nderohen viktimat, të dënohen autorët dhe të shtrohet rruga për pajtim, bazuar tek e vërteta dhe përkujtimi, rezoluta e PE thotë se kujtimi i viktimave të regjimeve totalitare, sikundër njohja dhe rritja e vetëdijes për trashëgiminë e përbashkët evropiane të krimeve të kryera nga diktaturat komuniste, naziste dhe të tjera, ka rëndësi jetike për unitetin e Evropës.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit 1944-1991, që prej themelimit, në bashkëpunim me partnerët, e ka vënë fokusin e punës së tij në zbardhjen e së kaluarës. Shenjimi i vendeve të kujtesës, takimet me të mbijetuar në kampe, propozimet për të nderuar shembujt e qëndresës, mbledhja e dëshmimeve, kontributi dhe organizimi i grupeve studimore, deklasifikimi i dosjeve dhe vënia në dispozicion, dokumentarët, ekspozitat që sjellin raste shqiptarësh të zhdukur dhe raste që familjet kanë mundur t’i gjejnë, veprimet konkrete të

përshkallëzuara për bashkërendim të punës së institucioneve në të gjitha nivelet, synojnë mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve të familjeve të personave të zhdukur, duke siguruar që vendndodhja e të zhdukurve dhe rrethanat e zhdukjes së tyre të hetohen në mënyrë efektive.









AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETËTIT

Adresa
Garda e Republikës, Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë
www.autoritetidosjeve.gov.al